



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Miratim në parim i projektligjit “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”

Marrin pjesë :

Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Elona Hoxha, Anduel Xhindi, Ervin Salianji , Xhemal Gjunksi, Isuf Çelaj, Myslym Murrizi, Sadi Vorpsi dhe Vullnet Sinaj,

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Paulin Sterkaj, Flamur Noka dhe Endrit Brahimllari

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministri i Mbrojtjes;

Alba Thoma - Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes,;

Gentiana Milkani - Drejtore e inspektimit në Autoritetin Kombëtar Shtetëror të Eksportimit të Armëve;

Eltiona Metani - Drejtore e Legjislacionit në Autoritetin Kombëtar Shtetëror të Eksportimit të Armëve.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Sigurisë. Sot në rendin e ditës është parashikuar miratimi në parim i projektligjit “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.

Ky është një projekt i iniciuar nga Ministria e Mbrojtjes. Ne jemi caktuar nga Konferenca e Kryetarëve dhe natyrisht edhe nga votimi në Kuvendin e Shqipërisë si komision përgjegjës për këtë projektligj. Komision për dhënie mendimi për këtë projekt, meqenëse bëhet fjalë për përafrim të pjesshëm me legjislacion ndërkombëtar, është caktuar Komisioni i Integritetit.

Sidoqoftë, ne sot bëjmë vetëm prezantimin e projektit dhe miratimin në parim të tij.

Për të prezantuar projektin, përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes dhe të ftuar njëkohësisht janë:

zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi;

sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes, Alba Thoma;

drejtorja e inspektimit në Autoritetin Kombëtar Shtetëror të Eksportimit të Armëve, Gentiana Milkani;

Drejtorja e Legjislacionit në Autoritetin Kombëtar Shtetëror të Eksportimit të Armëve, Eltiona Metani.

Faleminderit për prezencën tuaj!

Relator i Komisionit të Sigurisë Kombëtare është caktuar kolegu Vullnet Sina.

Fillojmë me prezantimin e projektit nga ana juaj, zoti zëvendësministër.

Urdhëroni!

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Kontrolli shtetëror mbi transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë është një çështje me rëndësi dhe sensibilitet të lartë për sigurinë kombëtare. Sigurisht, kjo vjen si pasojë e një detyrimi ndërkombëtar. Pra, transferimi i këtyre mallrave është nevojë dhe iniciativë ndërkombëtare, sepse ka qenë gjithmonë e nevojshme për t’u rregulluar. Për pasojë, ky projektligj është në përputhje me detyrimet që ne kemi si anëtarë të OKB-së dhe, përkatësisht, në zbatim të rezolutës 1540 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, por, gjithashtu, është edhe pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim-

Asocimit që ka firmosur Republika e Shqipërisë me BE-në. Ndërkohë, është e nevojshme të theksojmë se rregullorja e vjetër e BE-së, mbi të cilën është ndërtuar ligji në fuqi, është rrëzuar dhe është miratuar një rregullore e re, përkatësisht Rregullorja 428 e BE-së e datës 05.05.2009.

Projektligji i ri vjen si nevojë e përputhshmërisë së normave të këtij ligji me këtë rregullore. Për projektligjin është punuar në bashkëpunim ndërkombëtar, përkatësisht me ekspertë të Departamentit të Shtetit të SHBA-së, nëpërmjet programit EXBS, si dhe nga ekspertët e BE-së, nëpërmjet programit EU P2P *Export Control Programme*, të cilët na kanë asistuar rreth 2-3 vjet për hartimin e këtij projektligji.

Më lejoni të theksoj se zbatimi i ligjit në fuqi ka shënuar indikacione që kanë shprehur paqartësi dhe problematika, prandaj ka qenë e nevojshme që të krijohet një ligj i ri. Për shembull, sistemi i licencimit dhe autorizimit që parashikonte ky ligj ishte i paqartë në përkufizim dhe i papërputhur me rregulloret e BE-së. Për dokumentet që lëshonte AKSH-e, licenca dhe autorizimi kishin të njëjtat përkufizime, ndërkohë që ato janë dy gjëra të ndryshme. Gjithashtu, ligji i mëparshëm nuk bënte dallim mbi ndryshimin në konceptin e mallrave ushtarake dhe mallrave e artikujve me përdorim të dyfishtë, të cilat, pavarësisht ngjashmërisë përsëri kanë dallime thelbësore. Ligji i ri i përcakton më qartë dhe i ndan.

Për sa i përket këndvështrimit mbi programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Ministrisë së Mbrojtjes është në përputhje, si dhe është përfshirë në Planin Kombëtar të Integritetit Europian 2017-2020 të qeverisë. Besoj se për çështjet e tjera do të diskutojmë në momentin kur do të shqyrtohet ligji nën për nen.

Gjithsesi, nëse anëtarët e këtij komisioni të nderuar do të kenë pyetje konkrete, ne do t'u përgjigjemi duke përfshirë edhe dy drejtoreshat që janë nga Autoriteti Kombëtar Shtetëror i Eksportimit të Armëve.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Urdhëroni relatori, zoti Sina!

Vullnet Sinaj – Falënderoj zëvendësministrin për paraqitjen koncize që i bëri ligjit!

Unë do të shtoj vetëm disa gjëra lidhur me qëllimin e këtij ligji, që lidhet me vendosjen e kontrollit shtetëror mbi transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake, të artikujve dhe teknologjinë e përdorimit të mallrave me përdorim të dyfishtë për të siguruar mbrojtjen e interesave kombëtare të Republikës së Shqipërisë, sigurinë dhe politikën e jashtme, kredibilitetin ndërkombëtar të saj dhe garantimin e respektimit të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në këtë fushë.

Projektligji është propozuar të përfshihet në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Mbrojtjes, për vitin 2018, si dhe është përfshirë në PKIE 2017-2020.

Ligji nr.9707, datë 05.04.2007, “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar” është hartuar në përputhje të pjesshme me Rregulloren nr.1334/2000 të Bashkimit Europian, mbi krijimin e një regjimi komunitar për kontrollin e eksporteve të mallrave me përdorim të dyfishtë.

Rregullorja nr.428/2009 e datës 5 maj 2009 e Këshillit të Bashkimit Europian, e ndryshuar, që krijon një regjim komunitar për kontrollin e eksporteve, transferimeve, ndërmjetësimit dhe transitin e mallrave me përdorim të dyfishtë, ka shfuqizuar Rregulloren nr.1334/2000. Sistemi i licencimit dhe i autorizimit që parashikonte ky ligj ishte i paqartë në përkufizim dhe i papërputhur me rregulloret e BE-së. Për dokumentet që lëshonte AKSHE-ja, licenca/autorizime, kishte të njëjtat përkufizime, ndërkohë që ato, sipas ligjit dhe nga praktika e këtyre viteve, ishin dokumente të ndryshme.

Gjithashtu, ligji i mëparshëm nuk bënte dallim mbi ndryshimet në konceptin e mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, të cilat pavarësisht ngjashmërive në kontrollin e tyre kanë disa dallime thelbësore.

Këto dallime janë reflektuar në projektligjin e ri duke e ndarë mënyrën e licencimit të këtyre kategorive në dy kapituj të veçantë.

Nga ana tjetër, ky projektligj ka ndryshuar thelbësisht ligjin e mëparshëm, duke futur koncepte të reja, si dhe duke ndryshuar dhe duke përputhur me rregulloren e BE-së terminologjinë, licencimin, programin e përputhshmërisë etj.

Nga analiza që është bërë para fillimit të punës, bashkë me ekspertët e

Departamentit Amerikan të Shtetit, nëpërmjet programit EXBS, si dhe nga ekspertët e BE-së, nëpërmjet programit EU P2P *Export Control Programme*, të cilët na asistuan gjatë gjithë kohës së përgatitjes së projekt ligjit, u konkludua që në fillim për nevojën e një projektligji të ri

Gjithashtu, është përfshirë mundësia e miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave për një periudhë kohore të përcaktuar dhe një listë të caktuar mallrash, të cilat mund të jenë objekt kontrolli dhe licencimi nga AKSHE-ja.

Në nenin 11 të projektligjit janë parashikuar rastet e kontrollit shtetëror në transferimet ndërkombëtare edhe për mallrat dhe artikujt të cilët nuk janë të listuar në listën e kontrollit, por

nëse ekziston informacioni se këto mallra do të përdoren për qëllimet e përcaktuara në këtë nen, këto mallra do t'i nën shtrohen procedurës së kontrollit dhe të licencimit.

Në kreun VI është parashikuar një risi në këtë ligj, neni 36 “Kontrolli doganor”, ku përcaktohet mënyra e bashkëpunimit të AKSHE-së me Autoritetin Doganor mbi informimin për licencat e lëshuara dhe vendimet e marra, si dhe kompetencën e autoritetit doganor për të pezulluar procesin e transferimit dhe bllokuar mallrat, parashikim ky i cili i mungonte legjislacionit të mëparshëm, duke u gjendur përpara vështirësive në situata të tilla, ku asnjë organ nuk kishte të parashikuar kompetencën për të marrë këtë vendim.

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes. Gjithashtu, sqarojmë se procesi i hartimit të këtij projektligji ka nisur që në fillim të 2016 dhe gjatë gjithë kësaj kohe ky projektligj është konsultuar me ekspertët e Departamentit Amerikan të Shtetit, si dhe me ekspertët e Bashkimit European.

Me zbatimin e këtij projektligji do të ngarkohen Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Këtu do të thosha se në mbledhjen e ardhshme kur të diskutojmë nen për nen duhet të ketë edhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të cilët duhet që, ngaqë vetë janë në bashkëpunim me AKSHE-n, duhet të marrin pjesë në diskutimin e këtij projektligjit.

Në rast se ka nevoja për situata të ndërlikuara mund të thirren edhe ekspertë të huaj për sa u përket mendimeve apo kontrolleve për eksportin e këtyre mallrave.

Ky ligj nuk sjell efekte apo kosto, kështu që, nisur nga të gjitha këto arsye që përmenda, por edhe që zëvendësministri i përmendi këtu, i propozoj komisionit të bëjë miratimin në parim të këtij ligji.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sina!

A ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Duzha!

Luan Duzha - Faleminderit!

Sa subjekte janë të regjistruara nga AKSHE dhe a kanë pasur ndonjëherë probleme këto subjekte në shkeljen e procedurave të AKSHE-s? Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Metani!

Eltiona Metani - Faleminderit!

Nga ana e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve procedura për regjistrim bëhet për import-eksportin e mallrave ushtarakë, të cilat regjistrohen si subjekte. Që nga viti

2009 kur kemi filluar punën si institucion, deri tani duhet të jenë rreth 56 subjekte të regjistruara me certifikata regjistrimi që kanë të drejtë të merren me import-eksportin e mallrave ushtarake.

Ndërkohë, për mallrat me përdorim të dyfishtë nuk bëhet regjistrimi i tyre, thjesht, subjektet që interesohen për import-eksport mallrash me përdorim të dyfishtë pajisen me licenca. Faleminderit!

Ermonela Felaj – Meqenëse zoti relator ngriti një sugjerim, desha të dija nëse jeni konsultuar me Ministrinë e Financave, përkatësisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për këtë projekt.

Eltiona Metani – Po patjetër. Ne jua kemi dërguar për mendim projektligjin Ministrisë së Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të cilat kanë dhënë dakordësinë për këtë projektligj.

Ermonela Felaj – Kam edhe diçka tjetër, për të kuptuar edhe ne vijimësinë e punës me këtë projektligj. Tabela e përputhshmërisë a e shoqëron projektligjin apo jo?

(Diskutime pa mikrofon)

Faleminderit!

Unë besoj se do të kemi më shumë pyetje gjatë diskutimit nën për nën të projektit. Kujtoj se projekti është shumë teknik në terma dhe natyrisht kërkon kohën dhe kujdesin e nevojshëm që të përqendrohemi dhe të mund të kalojmë një draft sa më cilësorë nga pikëpamja e shkrimit.

Unë do të falënderoja edhe një herë prezencën tuaj!

Ndërkohë, do të ftoja kolegët për miratimin në parim të projektit!

Kush është dakord me projektin?

Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA